

## AKT THEMELIMI

---

### Shoqeria “Europump” sh.p.k

Sot më datë 10 / 08 / 2022, une i nënshkruari **z. Andi Çelaj** shtetas shqiptarë, i datelindjes 01.03.1983, lindur ne Vlore, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr I303010671 shpreh vullnetin tim për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “Europump” sh.p.k si më poshtë vijon:

#### 1. FORMA LIGJORE

“Europump” sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

#### 2. ORTAKET THEMELUES

Ortaku i vetem themelues i shoqërisë është Andi Çelaj

#### 3. OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “Europump” sh.p.k është “Tregetimi me shumice dhe pakice i materialeve hidraulike, Pompa te ndryshme per uji, Pompa Kanalizimesh, Pompa Dozimi, Pompa qarkullimi, Pompa Vadiqe, Rubineteri te te gjitha llojeve, hidrosanitare, ndertimi, elektrike, elektronike, materiale te ndryshme izolimi, profile te ndryshme matalike, materiale amablazhi dhe kimikate. Te kryej montimin apo instalimin e tyre. Te kryej sherbimin e transportit te mallrave e sherbimeve per vete dhe per te tretet.”

#### 4. SELIA

Selia e shoqërisë tregtare “Europump” sh.p.k është në adresën: Tirane KASHAR KASHAR Rruga EGNATIA, Zona kadastrale 2105, Nr pasurie 1156/37

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [info@europump.al](mailto:info@europump.al)

Shoqëria ka të drejtë të hapë degë dhe të zhvillojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### 5. KOHËZGJATJA

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në paragrafin 1, te ketij neni mund të shkurtohet me vendim të Asamblese se Ortakeve të shoqërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Statuti i shoqërisë.



## 6. KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare **“Europump” sh.p.k.** është 100.000 (Njeqind mije) leke i perfaqesuar nga 1 kuote , vlera nominale e te ciles eshte 100.000 (Njeqind mije) leke Ortaku i vetem eshte zoterues i kuotes qe perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise Kuotat jane nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë. Kuota përfaqëson të drejtën e një votë.

## 7. ORTAKET

Ortaket i ushtrojne kompetencat qe ligji i jep Asamblesë së Ortakeve.

## 8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

- Shoqëria drejtohet nga 1(nje) Administrator.
- Administratori i shoqërisë **“Europump” sh.p.k** do te jete **z. Andi Çelaj**
- Administratori emërohet me Vendim të Asamblese se Ortakeve, për një periudhë jo më shumë se 5 (pese) vjet me te drejte ripërtëritjeje.
- Përfaqësimi i shoqërisë tregtare **“Europump” sh.p.k** në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe statuti, i përket administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkoje për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## 9. SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

**THEMELUESI**

**Andi Çelaj**

